



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2018:028600

Datë: 26.08.2022

Numri i dokumentit: 03363716

P.nr.1013/2016

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtares të vetëme gjykuese Mevlide Shabani, me bashkëpunoren profesionale Albinë Velekinca-Sadiku, në çështjen penale kundër të pandehurit Z. Zh., nga fshatin P.,Komuna e Novobërda, për shkak të veprës penale falsifikim i dokumenteve nga neni 398 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së), duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, me numër PP.II.nr..../2016, të datës 12.08.2016, e duke vepruar sipas detyrës zyrtare, jashtë seance me datën 23.08.2022 mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. **HUDHET** poshtë aktakuza e Prokurorisë Themelore në Gjilan me numër **PP.II.nr..../2016**, e datës 12.08.2016 dhe **PUSHOHET** procedura penale ndaj të pandehurit Z. Zh., nga fshatin P.,Komuna e Novobërda, për shkak të veprës penale falsifikim i dokumenteve nga neni 398 paragrafi 1 të KPRK-së, nga se vepra penale për të cilën akuzohet i njejti tani më është përfshirë në parashkrimin absolut të ndjekjes penale.
- II. Shpenzimet e procedurës penale paguhen nga mjetet buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan me datë 12.08.2016, ka ngritur aktakuzën me numër PP.II.nr../2016, kundër të pandehurit Z. Zh. , nga fshatin P., Komuna e Novobërda, për shkak të veprës penale falsifikim i dokumenteve nga neni 398 paragrafi 1 të KPRK-së.

Gjyqtarja e vetme gjykuese pas shqyrtimit dhe vleresimit të shkresave të saj, duke vepruar sipas detyrës zyrtare, konstatoi se në rastin konkret ka arritur afati kohor i ndaleses absolute të ndjekjes penale, neni 106, par.1.6 të KPK-se, vepra penale e cila është e dënueshme me gjobe ose burgim e dënueshme deri në 1 (një) vit, parashkruhet kur të kenë kaluar 2 (dy) vite nga data e kryerjes së veprës penale (parashkrimi relativ), ndërsa në bazë të nenit 107, par.8 të

KPK-se, ndjekja penale ndalohet ne çdo rast kur të kete kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit, e në rastin konkret kanë kaluar **6 (gjashtë) vite**, përkatësisht dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit nga kryerja e vepres penale e cila i vihet në barrë të pandehurit ngase vepra penale është kryer në vitin **2016**, ndërsa ndalesa absolute e ndjekjes penale është arritur në fillim të vitit **2022**.

Andaj, nga të lartcekurat dhe në bazë të nenit 358 paragrafi 1, nën paragrafi 1.3, nenit 106 paragrafi 1, nën paragrafi 1.6 dhe nenit 107 paragrafi 8 të KPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr.1013/2016, me datë 23.08.2022

Gjyqtarja,
Mevlide Shabani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, mund të ushtrohet ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, brenda afatit prej 3 (tri) ditëve nga dita e pranimit të aktvendimit, e nëpërmjet të kësaj Gjykate.